



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. Date 28.02.2022

“PËR MIRATIMIN E SHTESAVE DHE PAKËSIMEVE BUXHETORE”.

Në mbështetje të nenit 54, pika “dh”, të ligjit 139/2015 “Për Veteqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936,dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit 68/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 37/2015, datë 09.04.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësisimit (IPA II)”, Vendimit të Komisionit Europian No C(2015) 5482, datë 30.07.2015 „Për miratimin e Programit Interreg IPA Greece-Albania 2014-2020“, Ligjit nr. 137/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Europian për Programin Interreg IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020“, Kontratave të Granteve për projektet, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.72, datë 22.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2022” në mbledhjen e datës 28.02.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1.Miratimin e shtesave buxhetore, si me poshte:

Të shtohen të ardhurat:

1- Nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2021 (Kapitulli 5) për	9.024.098 lek
2- Shtesa për projekte ndërkufitare nga “INTEREG”- IPA 2014-2020	120.707.588 lek
Totali (shtesa)	129.431.686 lek

Të Shtohen shpenzimet:

-Gr.00.Tit.04520 .Kap.5.Art .231 për	648.188 lek
-Gr.00.Tit.04240 .Kap.5.Art .231 për	500.000 lek
-Gr.00.Tit.06260 .Kap.5.Art .231 për	2.200.000 lek
-Gr.00. Tit.01110. Kap.5.Art. 231 për	1.200.000 lek
-Gr.00.Tit 01110. Kap.5.Art. 602 për	2.975.910 lek
-Gr.00.Tit.04520. Kap.5.Art. 602 për	1.200.000 lek

-Gr.00. Tit.06330. Kap.5.Art. 231 për 300.000 lek

-Polyphonia - A2-2.1-9 Gr.00 Tit 08220 Kap.2 art.230 per : 4 681 250 lek

-Extrovert roads extention -A2-1.1-7. Gr.00. Tit 04520 Kap.2. art.230 per: 69 464 463 lek

-CLLD-CULTOUR - A2.2.1 Gr.00 Tit 08220 Kap.2 art.230 per : 14 373 750 lek

-SOCIALE –E. CTR2021/425-719. Gr. 00. Tit 08220. Kap.2 art.230 per : 31 888 125 lek

Totali (shtesa) **129.431.686 lek**

2. Miratimin e pakësimeve buxhetore, si me poshtë:

Të Pakësohen të ardhurat:

Pakësim nga transf.e pakushtëzuar, e trashëguar nga viti 2021. (kap.1) për 648.188 lek

Të pakësohen shpenzimet:

1-Gr.00.Tit. 04520 .Kap.1. Art . 231 per 648.188 lek

3. Ngarkohet Drejtoria e Financës. Buxhetit dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi .

4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 „pika 6 te ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETAR

Donika BAUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL

DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE MBROJTJES SOCIALE.

RELACION

“PER MIRATIMIN E SHITESAVE DHE PAKËSIMEVE BUXHETORE”.

Shtesa buxhetore.

Gjate procesit të zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të Bashkisë, për të mundësuar ndjekjen e dinamikës së zhvillimeve dhe ndryshimeve ekonomike, Ju paraqesim shkaqet dhe kërkojmë miratimin Tuaj, për Shtesa/pakësime të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Duhet pasur parasysh që buxheti i Bashkisë për vitin në vazhdim 2022, është paraqitur, diskutuar dhe miratuar ende pa u mbyllur aktiviteti ekonomik i vitit të mëparshëm 2021, kështu që detyrimisht do të ketë ndryshime në të ardhurat që grumbullojmë nga burimet e veta të brendshme, por edhe ndryshime në shpenzimet që realizuam me ndikim në shpenzimet që mbeten pa u përdorur, të cilat paraqiten si të ardhura të trashëguara nga viti 2021 në buxhetin e vitit 2022.

Konkretisht nga mbyllja e logarive financiare të vitit 2021, ku afati i tyre është muaji Shkurt 2022, rezultojnë të ardhura, si të ardhura të trashëguara nga viti 2021 (Kapitulli 5), përveç 6.590.000 lek të paraqitura dhe miratuar në buxhetin e vitit 2022, edhe 9.024.098 lek shtesë. Por duke u shtuar të ardhurat, do duhen shtuar edhe shpenzimet, pasi buxheti sipas ligjit duhet të jetë i ballancuar. Prandaj në buxhetin e vitit 2022, duhen bërë në këtë vlerë, shtim të shpenzimeve të planifikuara

Gjithashtu po nga mbyllja e llogarive financiare (bilancit) të vitit 2021, përse i përket shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2021, që i planifikojmë si transfertë të pakushtëzuar të trashëguar (grant i trashëguar) tek Kapitulli 1, në buxhetin e vitit 2022, nga 24.128.000 lek, rezultojnë 648.000 lek më pak. Prandaj në buxhetin e vitit 2022, duhen bërë në këtë vlerë, pakësim të shpenzimeve të planifikuara.

Në mënyrë të përmbledhur nga ana Grupit Menaxhim, Strategji (GMS) të Bashkisë, propozohet për miratim të shpenzimeve shtesë, por edhe pakësim të shpenzimeve në një rast (për vlerën e cituar në paragrafin e mësipërm), për programet, llojet dhe aktivitetet, si më poshtë:

-Shtesë të shpenzimeve për të mbështetur investimet në programin Rrugë rurale, rrugë të brendshme dhe menaxhim të transportit rrugor (04520), nga kapitulli 5 (ardhura të trashëguara), në masën 684.000 lek, që ishin të planifikuara në buxhetin e vitit 2022, nga granti i trashëguar, Kapitulli 1, por që rezultojnë me pakësim.

-Shtesë të shpenzimeve për të mundësuar plotësisht kryerjen e investimit të rëndësishëm në programin 04240 (kullimi, ujitja), Blerje mjet germimi (JCB), duke pasur parasysh kushtet e ndryshuara të rregjimit të hyrjes së mjeteve të përdorura në Republikën e Shqipërisë (duhen euro-4, prodhim pas vitit 2007), do duhet të shtojmë në këtë zë edhe 500.000 lek të tjera.

-Shtesë shpenzimesh për të arritur realizimin e objektivave në shërbimet publike, programi 06260 dhe mundësuar vazhdimin e transportit të punëtorëve nëpër frontet e punës të cilat ndryshojnë vazhdimisht, si dhe për të mundësuar që mjeti që përdoret aktualisht për këtë qëllim, ti kthehet programit të kullimit dhe ujitjes, planifikojmë shpenzime për investime (art.231), për progr.06260, për blerje mjeti 4x4 me karoceri në vlerën 2.200.000 lek.

-Shtesë shpenzimesh, duke pasur parasysh kriterin ligjor, që nuk mund të bëjmë investime të reja pa realizuar ato të programuara në vitin e mëparshëm dhe meqenëse nuk u realizua në vitin 2022, investimi në progr. 01110 për ngrohjen qendrore të zyrave të Bashkisë, në vlerën

3.000.000 lek, planifikojmë shpenzime për investime për ngrohje lokale (kondicionerë) në vlerën 1.200.000 lek.

-Shtesë shpenzimesh, ku për të mundësuar realizimin e detyrave në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane (06260), të caktuara nga Qeveria Qëndrore, u detyruam që të shtonim në buxhetin që miratim në Dhjetor 2021, shpenzimet prej 2.000.000 lek në këtë program, të cilat i hoqëm nga programi 01110, art.602, por ato ishin të domosdoshme, prandaj duke pasur shtesë të ardhurash propozojmë miratim të shtesës së shpenzimeve të artikullit 602, në programin 01110, në masën 2.975.910 lek, të përbërë nga 2.000.000 të planifikuara fillimisht dhe të hequr në Dhjetor 2021; 400.000 lek për lidhjet e energjisë elektrike me veprat e ujësjellësave që po përfundojnë dhe 575.910 lek për oponencat e projekteve të zbatuara.

-Shtesë shpenzimesh për të mundësuar ndërhyrjet në akset rrugore problematike, kryesisht në Njësinë Administrative Pogon, por edhe ndonjë ndërhyrje në fshatrat e thella të të Dropullit të Sipërm, planifikojmë shtim të shpenzimeve materiale (beton, tombino), në art.602 në programin 04520, në shumën 1.200.000 lek.

-Shtesë shpenzimesh në artikullin 231, për kryerjen e kolaudimit të projektit të investimeve për ndërtimin e ujësjellësit nga pus-shpimet, në programin 06330, furnizimin me ujë të komunitetit, në vlerën 300.000 lek.

Gjithashtu Bashkia jonë, tashme ka krijuar një eksperiencë lidhur me aplikimin e projekteve të ndryshme në kuadër të programeve të bashkëpunimit ndërkufutar Greqi-Shqipëri, INTEREG-IPA II, 2014-2020. Kështu, bazuar në Ligjin nr. 37/2015, datë 09.04.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”, Vendimit të Komisionit Europian No C(2015) 5482, 30-07-2015 për miratimin e Programit Interreg IPA Greece-Albania 2014-2020, Ligjit nr. 137/2016 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Europian për Programin “Interreg IPA“ të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020, si dhe kontratave të Granteve për projektet e aplikuara dhe të perfituara, është e nevojshme që pjesa që do levrohet dhe do zbatohet projekti gjatë këtij viti dhe viteve të tjera në vazhdim, **të përfshihet në buxhetin e Bashkisë për vitin 2022, si shtesë në të ardhura dhe shtesë në shpenzime për projektet e meposhtme dhe konkretisht:**

-Polyphonia - A2-2.1-9 Gr.00 Tit 08220 Kap.2 art.230 per : 4 681 250 lek

(Projekt kulturor në vazhdim me synim promovimin e traditës së polifonisë dhe përcjelljen në brejat e rinj në të dy anët e kufirit me Republikën e Greqisë)

-Extrovert roads extention -A2-1.1-7. Gr.00. Tit 04520 Kap.2. art.230 per: 69.464.463 lek.

(Projekt që synon realizimin e rikonstruksionit të rrugës hyrëse në fshatrat Bularat-Bodrishtë)

-CLLD-CULTOUR - A2.2.1 Gr.00 Tit 08220 Kap.2 art.230 per : 14.373.750 lek.
(projekt kulturor në vazhdim)

-SOCIALE –E. CTR2021/425-719. Gr. 00. Tit 08220. Kap.2 art.230 per : 31.888.125 lek

(Projekt me delegacionin e Bashkimit Evropian- Social enterprise Accelerator and Incubator for women and youth of the Greek Minority”, me titull “SOCIAL-E: Social enterprise

Accelerator and Incubator for women and youth of the Greek Minority”, me kod EuropeAid / 168946 / DD / ACT / AL BE, ne vlere 31.036.074 lek, si edhe në relacionin që i bashkangjitej këtij vendimi, ku bëhet fjale për rikonstruksionin e plotë të ish shkollës fillore në fshatin Dervician dhe krijimin aty të një ekspozite dhe tregu online të produkteve vendore nga gratë dhe grupe të tjera në nevojë si dhe të të rinjve të Bashkisë.

Pakësime buxhetore.

Gjithashtu po nga mbyllja e llogarive financiare (bilancit) të vitit 2021, përsa i përket grantit të trashëguar nga shpenzimet e pakryera gjatë vitit 2021, që i planifikojmë si të ardhura nga granti i trashëguar (Kapitulli 1), në buxhetin e vitit 2022, nga 24.128.000 lek, që i kemi miratuar në muajin Dhjetor 2021, rezultojnë 648.188 lek më pak. Prandaj kërkojmë miratimin për pakësimin e të ardhurave nga kapitulli 1, në buxhetin e vitit 2022, në vlerën 648.188 lek, si dhe pakësim të shpenzimeve të planifikuara, ku përsëri kërkojmë miratimin për pakësimin e shpenzimeve në vlerë 648.188 lek, që i kemi planifikuar në programin 04520, art.231(investime)..

Konceptoi: K.Lengo

Miratoi : TH.Pullà

KRYETARI I BASHKIS
Dhimitraq TOLI

